

URDHËR
Nr. 151, datë 7.8.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar, urdhrit të Kryeministrit nr. 1, datë 8.1.2025, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm, për nënshkrimin e korrespondencave/shkresave hyrëse dhe dalëse të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit te znj. Alisa Basha, aktualisht me pozicion drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data 8.8.2025 deri më datë 18.8.2025.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, znj. Alisa Basha dhe Drejtoria Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve, pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka